

AKT THEMELIMI

I shoqërise tregtare ONDINE sh.p.k

Sot, më 14.07.2022, mbështetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Për shoqërite tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nenshkrimin e këtij akt-themelimi ne ortaket :

- 1- **Paola Tonin Dashi** person fizik me numer personal **J35820046P**, banues në Shëngjin, Lezhë.
- 2- **Vjollcë Pashuk Dashi** person fizik me numer personal **H25909046G**, banues në Shëngjin, Lezhë.

të krijojnë shoqërine tregtare me përgjegjesi të kufizuar **ONDINE sh.p.k** me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formulimi

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **ONDINE sh.p.k**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarine e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërise që do të miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Selia e Shoqërise

Selia e shoqërise tregtare private do të jetë në **Lezhë, Shëngjin, shëtitorja Wilson, godina nr. 46 , kati perdhe i godines, zona kadastrale nr. 3126, me numer pasurie 3/126**. Shoqëria mund të ndryshoje seline e saj, të hape zyra përfaqesie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese së ortakeve.

Neni 3

Objektivi i Veprimtarise

Shoqëria do të zhvillojë aktivitete në fushen e :

- Prodhimi dhe tregtimi i akulloreve, yogurtit, waffle etj. dhe Bar-Kafe. Import i lendes se pare per akullore. Sherbim delivery (sherbim te produkteve me transport ne shtepi).
- Organizimi i aktiviteteve te ndryshme si evente, festa, veprimtari promocionale kulturore, sherbime marketingu dhe promocioni, ushtrimi i aktivitetit si lokal, bar,

club, nightclub, hoteleri, restaurant, spa, sherbime te ndryshme ne lidhje me aktivitetin e pushimit ne plazh, organizimin e aktiviteteve dhe lojrave te ndryshme ne det dhe/ose ne toke.

- Dhenie me qira te mjeteve motorike dhe/ose jo motorrike, qofshin keto lundruese dhe/ose tokesore.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohe dhe për çfardo lloj shkak .

Neni 5

Kapitali i Shoqërise

Kapitali i shoqërise është 100,000. Leke(njeqind mije lek) i përbëre nga 2 (dy) kuota dhe zoterohet nga ortakët e shoqërise si më poshte :

Ortaku Themelues: Paola Tonin Dashi, zoteruese e 1 kuote me vlere te pergjithshme 80.000 lek, te cilat perfaqesojne 80 % te kapitalit te shoqerise.

Ortaku Themelues: Vjollcë Pashuk Dashi, zoteruese e 1 kuote me vlere te pergjithshme 20.000 lek, te cilat perfaqesojne 20 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar 100,000 Lek

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar 100.000 Lek

Neni 6

Drejtimi i Shoqërise

Shoqëria do të drejtohet nga administratoria Vjollcë Dashi e cila është përfaqesuese ligjore e saj. Administratoria është përfaqesuese e Shoqërise në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Çdo kontrate do të kryhet prej saj dhe në rast mungese, nga një përfaqesues i pajisur me prokure të posaçme .

Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërise i takojne ortakeve të shoqërise.

Neni 8

Ortakët themelues të shoqërise kane të drejte të emeroje dhe administratore të tjerë te vlerave material. Kane të drejte të caktoje financiere, likuidator për problemet e shoqërise si dhe të pajtoje persona të tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Neni 10

Shoqëria ka vullen e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plote të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 12

Akti i themelimit u përpilua në 4 kopje, për t’ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **ONDINE sh.p.k.**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët Themelues Të Shoqërisë

ONDINE sh.p.k

PAOLA DASHI

PAOLA DASHI



VJOLLCË DASHI

Vjollcë Dashi

